



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 8788 Prot.

Fier, më 25.07.2025

PROJEKT VENDIM
Nr. 73, datë 25.07.2025

PËR DHËNIE NDIHME SHTETËRORE FINANCIARE

Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit shtetasit Panajot Gjika, fshati Seman i Ri, Njësia Administrative Topojë, i dëmtuar nga zjarri i datës 04.07.2025.

Në mbështetje të nenit 3, pikës 1.1 të nenit 9, dhe nenit 29 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendore”*, nenit 30 dhe 41 të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 *“Për Mbrojtjen Civile”*, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 *“Për financat e vetëqeverisjes vendore”*, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier nr.139, datë 23.12.2024 *“Për miratimin e buxhetit të vitit 2025”* si dhe në zbatim të shkronjave “e” dhe “ë” të pikës 1, të paragrafit III, të V.K.M-së Nr.329 datë 16.05.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”*, kreu III pika 1, për dëmin e shkaktuar nga zjarri i datës 04.07.2025, shkresës zyrtare nr.713/1.prot, datë 25.07.2025 *“Vlerësim dëmi”* të Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Zhvillimit të Projekteve, Këshilli i Qarkut Fier, si dhe Preventivit bashkëlidhur kësaj shkrese, ku ka rezultuar se në banesën e shtetasit Panajot Gjika dëmi në orëndi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake është në vlerën 99 000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë dhe në anën ndërtimore në vlerën 84 671 (tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) lekë, ndaj bazuar në nenin 30, shkronja“gj”, e ligjit 45/2019,

PROPOZON:

1. Dhënien e ndihmës financiare prej Bashkisë Fier për shtetasin Panajot Gjika, në masën 100%, për dëmet e shkaktuara në orëndi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake, në vlerën prej 99 000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë.
2. Dhënien e ndihmës prej Bashkisë Fier në masën 50%, për dëmet e shkaktuara në anën ndërtimore të banesës, në vlerën prej 42 335 (dyzetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë , konform përcaktimeve ligjore të pikës 3, gërmës “ç” “Përcaktimi i ndihmës financiare” e VKM nr.329 datë 16.05.2012.
3. Vlera totale fianciare e dhënies së ndihmës sipas pikave 1 dhe 2 të këtij projekt vendimi për shtetasin Panajot Gjika është në masën 141 335 (njëqind e dyzetë e një mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile si dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Drejtoria e Mbrojtjes Civile
Nasip BANI

Drejtoria Juridike
Esmeralda KAPLLANAJ

Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
Pranvera ÇINA

KRYETARI
Armando SUBASHI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËS KRYETAR

Vasil BREGU

